



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI**

Nr. 16985 prot.

Tiranë, më 17. 10.2025

URDHËR

Nr. 134, datë 17. 10.2025

“PËR

**MIRATIMIN E MANUALIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
NË SEKTORIN PUBLIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, shkronjës “c” të nenit 23 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm, sipas dokumentit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, titullarët e njësive publike, drejtuesit e njësive të auditimit të brendshëm dhe audituesit e brendshëm në sektorin publik, që janë subjekte të zbatimit të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 01.01.2026.

MINISTRI

Petrit Malaj

